




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Raport i Diskutimit Publik për Draft Planin e Integritetit për Komunën e Podujevës 2023-2027

Në bazë të vendimit nr. prot.02-020/04-0034928/22, të datës 18.05.2022, është ngritur Grupi Punues për hartimin e Planit të Integritetit me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kontroleve ekzistuese, zhvillimin të përgjithshëm të sistemit të menaxhimit të integritetit, përmbushjes së objektivave të integritetit dhe forcimin e zbatimit të legjislacionit dhe standardeve profesionale në kuadër të Komunës së Podujevës.

Grupi punues ka përgatitur Draftin e planit të Integritetit që paraqet një dokument strategjik dhe konsiderohet si mjet i rëndësishëm parandalues për fuqizimin e integritetit institucional, gjithashtu ky draft është i harmonizuar me obligimet strategjike të përcaktuara nga Strategjia e Kosovës Kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit 2021-2023, në të cilat parashihet roli kyç i Komunave në zhvillimin dhe implementimin e Kornizës së Integritetit.

Ky Draft Plani i Integritetit synon të kontribuoj në ndërtimin e një administrate komunale profesionale dhe të modernizuar, të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik lokal me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efektive dhe cilësore për të gjithë.

Drafti i Planit të Integritetit është përgatitur dhe proceduar në Kuvend më datë 15 maj 2023, diskutimi publik ka zgjatë 30 ditë përkatësisht prej datës 12 prill 2023, deri më datë 11 maj 2023, brenda kësaj periudhe kohore propozimet, sugjerimet, vërejtjet, kanë pasë mundësinë që të paraqiten sa ka zgjatë koha e diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike në e-mail adresën; osman.bajrami@rks-gov.net.

Debati i përgjithshëm publik me qytetarë është caktuar të mbahet më 02 maj 2023 duke filluar nga ora 10:00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve, mirëpo edhe pse janë bërë njoftimet dhe lajmërimet për t'i paraqitur propozimet, vërejtjet apo sqarimet nuk ka pasur pjesëmarrës në diskutim publik e as ndonjë vërejtje sugjerim apo propozim të adresuar në formë fizike dhe elektronike.

Nr.prot. 01-401/04-0040690/23
Podujevë, datë 14.06.2023

Raportin e përgatiti
Osman Bajrami